



Datë: 9 Shtator 2025

Për: znj. Arbërie Nagavci, Ministre e Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit

Nga: Koalicioni i OJQ-ve për Mbrojtjen e Fëmijëve – KOMF

Lënda: Kërkesë

E nderuar Ministre Nagavci,

KOMF me vëmendje ka përcjellur njoftimin për hapjen e thirrjes për regjistrimin e institucioneve të edukimit në fëmijërinë e hershme në kuadër të Programit të Kuponëve, i cili do të zbatohet deri në qershor të vitit 2028 dhe ka për qëllim mbështetjen e familjeve përfituese të Skemës së Asistencës Sociale.

KOMF mirëpret këtë nismë të Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit si një hap pozitiv drejt barazisë sociale dhe përfshirjes së fëmijëve nga familjet në nevojë, megjithatë, shprehim shqetësimin lidhur me mungesën e përfshirjes së fëmijëve me aftësi të kufizuara në këtë program, të cilët përballen me një mori barrierash për qasje në edukimin në fëmijërinë e hershme.

Fëmijët me aftësi të kufizuara vazhdojnë të kenë përfshirje tejet të ulët në institucionet e edukimit të hershëm publike dhe sidomos në ato private. Kjo situatë rëndohet më shumë nga:

- Shpenzimet shumë të larta të prindërve për sigurimin e asistentëve për fëmijët me aftësi të kufizuara në institucionet për edukimin e hershëm;
- Kostot e larta të shërbimeve profesionale rehabilituese mbështetëse për fëmijët me aftësi të kufizuara (shërbimet psikologjike, sociale, logopedike, ergoterapeutike, fizioterapeutike, etj.), shpenzime të cilat rëndojnë tej mase familjet që gjithsesi përballen me vështirësi të mëdha ekonomike. Aktualisht, ka familje që paguajnë deri në 600–700 Euro në muaj, pasi duhet të mbulojnë shpenzimet për kopshtin privat, pagesën e asistentit për fëmijën me aftësi të kufizuara dhe shërbimet profesionale.

Bazuar në këto fakte dhe në obligimin kushteutes dhe ligjor të Republikës së Kosovës për garantimin e të drejtave të fëmijëve me aftësi të kufizuara pa diskriminim, KOMF kërkon që në Programin e Kuponëve të përfshihen edhe fëmijët me aftësi të kufizuara, pavarësisht nëse familjet e tyre janë përfituese në Skemën e Asistencës Sociale apo jo.

Bazuar në Udhëzimin Administrativ Nr. 03/2022 për përfshirjen e fëmijëve në institucione parashkollore në Kosovë, neni 4 - Kriteret për regjistrim të fëmijëve në institucionet parashkollore përcakton që fëmijët që vijnë nga grupet e rrezikuara, përfshirë fëmijët me nevoja të veçanta, lirohen nga pagesa.

Duke marrë parasysh specifikat individuale dhe nevojat e shumta që kanë fëmijët me aftësi të kufizuara, vlerësojmë se kostoja e kuponëve për mbështetjen e fëmijëve me aftësi të kufizuara duhet të jetë më e lartë, për të reflektuar mbështetjen e shtuar profesionale që është e domosdoshme për përfshirjen e tyre efektive në edukimin e hershëm. Poashtu, është e rëndësishme që në aplikim të rregullohet çështja e moshës së fëmijëve me aftësi të kufizuara, pasi aktualisht ai lejon regjistrimin deri në moshën 4 vjet

e 6 muaj, ndërkohë që jemi të vetëdijshëm që tek një pjesë e fëmijëve me aftësi të kufizuara moshë kalendarike nuk përputhet me moshën zhvillimore. Ne kemi fëmijë të moshës 5 vjeç të cilët, sipas vlerësimit të ekipit komunal/psikologut klinik, kanë nevojë të vazhdojnë edhe një vit tjetër në kopsht.

Përfshirja e tyre në këtë program do të:

- Nxisë gjithëpërfshirjen e fëmijëve me aftësi të kufizuara në edukimin në fëmijërinë e hershme.
- Lehtësojë barrën financiare të prindërve të fëmijëve me aftësi të kufizuara.
- Përbush obligimet ligjore të Republikës së Kosovës në raport me Konventën për të Drejtat e Fëmijës të përfshirë në Kushtetutën e Republikës së Kosovës.

Presim që kjo kërkesë të reflektohet në zbatimin e mëtejshëm të Programit të Kuponëve.

Me respekt,

Koalicioni i OJQ-ve për Mbrojtjen e Fëmijëve – KOMF